

Autoriteti Bankar dhe I Pagesave te Kosoves

Në pajtim me autoritetin që i'u është dhënë sipas Nenint 17.b të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24 të datës 1 Tetor 2001 mbi Amandamentin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës si dhe Nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/25 të datës 5 Tetor 2001 mbi Licensimin, Mbikqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit,

Më qëllim të ekzekutimit të Nenit 13 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Udhëheqës I Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars 2002 adoptoi siq vijon:

Rregulli 5 S plotësues mbi Licencimin e Ndërmjetsuesve të Sigurimit

Neni 1

Licencimi I kategorive shtesë të ndërmjetësuesve të sigurimit

1.1 Arsyeya kryesore e këtyre rregullave plotsuese

BPK-ja pranon nevojën dhe rendësinë e pjesëmarrjes së ndërmjetësuesve të sigurimeve përveç të agjentëve, nën-agjentëve dhe brokerëve në zhvillimin e një industrie stabile të sigurimeve në Kosovë meqenëse është duke ndërtuar kapacitetet adekuate lokale.

1.2 Shtrirja e Rregullit

Ky rregull dhe rregullat e përshkruara në vijim aplikohen të gjithë aplikantët që kërkojnë licencë për të vazhduar biznesin si ndërmjetësues të sigurimeve të tipeve dhe kategorive që nuk janë përmendur në Rregullin 5 të BPK-së mbi Licencimin ndërmjetësuesve të sigurimeve duke përfshirë, por jo të limituara, këto:

- a. **Rregulluesit e dëmeve të sigurimit/Kontrollor**
- b. **Broker të Linjave Tepricë (brokerët që shesin aksione e që të tjerët nuk I shesin)**
- c. **Brokerët e Risigurimeve**

1.3 Aplikimi I Rregullit 5 ka hyrë në Fuqi me 18 Tetor 2001

Përderisa, dhe deri në atë masë që dispozitat specifike të Rregullit Plotësues nuk shtojnë, ndërrojnë apo modifikojnë kushtet, kualifikimet dhe/apo kërkesat e përshkruara në rregullin e tanishëm (Rregulli 513), dispozitat e rregullit 5 në Rregullat e BPK-së mbi Licencimin e ndërmjetsuesve të sigurimeve aplikohen për të gjithë aplikantët që kërkojnë të vazhdojnë me biznes si ndërmjetsues të sigurimeve sipas Rregullave Plotsuese.

Neni 2

Rregullat shtesë mbi Licencimin e ndërmjetsuesve tjerë të sigurimeve

Licencimi I ndërmjetsuesve të sigurimeve të përshkruar në këtë Rregull përfshinë tipe dhe kategori të ndryshme të ndërmjetsuesve të sigurimeve përvec agjentëve, nën-agjentëve dhe brokerëve që janë çështje të rregullave specifike të cilat mund të përshkruhen nga BPK nën rregullat plotësuese mbi licencim në përputhje me Rregullin 5 dhe këtë Rregull.

Rregullat plotësuese që nxirren nga ky Rregull do të numërohen si Rregulli 5 të përcjellur nga alfa modifikuesi në rend. Rregullat plotësuese fillestare janë të identifikuara dhe të citura si në vijim:

- | | | |
|-----------|--------------------|--|
| a. | Rregulli 5A | Mbi Rregulluesit e dëmeve të sigurimit/Kontrollor |
| b. | Rregulli 5B | Mbi Brokerët e Linjave Tepricë (brokerët që shesin aksione e që të tjerët nuk I shesin) |
| c. | Rregulli 5C | Mbi Brokerët e Risigurimeve |

Neni 3

Hyrja në Fuqi

Rregulli i tanishëm duhet të hyjë në fuqi me 1 Prill 2002.

Drejtori Menaxhues